UNIVERSITETI PUBLIK " KADRI ZEKA " UNIVERSITY
Rr. Zija Shemsiu, Nr.183, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës
Tel: 0280390112 **www.uni-gjilan.net**

Nr.Prot: 01 / 2749 **Datë:** 26 / 11 / 2026

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka'' në Gjilan, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, dhe Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/1328 të datës 26.06.2024, në mbledhjen e mbajtur më datë 20.11.2026 vendos të shpall:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për këto Fakulte:

I. FAKULTETI JURIDIK

Avancime ose riemërim

1. Një mësimdhënës për lëndët: Historia e institucioneve shtetërore dhe juridike - 3 orë (O); Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare – 3 orë (O); Sociologjia juridike - 2 orë (Z); Historia e Diplomacisë - 2 orë (Z); E drejta diplomatike dhe konzulare - 3 orë (O); E drejta e traktateve Ndërkombëtare - 2 orë (Z) dhe Siguria kolektive ndërkombëtare dhe NATO - 3 orë (O).

Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse

1. Një mësimdhënës për lëndët: Teoria dhe praktika parlamentare - 3 orë (O), Sistemi Politik i Kosovës -2 orë (Z), Seminar (Projekt hulumtues) - 2 orë (Z), E drejta kushtetuese pozitive - 3 orë (O), Gjyqësia kushtetuese - 2 orë (Z), Etika Profesionale në Administratë - 2 orë (Z) (E-Qeverisja).

II. FAKLUTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse

1. Një mësimdhënës për lëndët: Programimi PLC - 2 orë (O), Sistemet e bazuara në senzorë - 2 orë (O), Analiza e Sistemeve të Kontrollit dhe Dizajnimi - 2 orë (O), Sistemet e Integruara dhe Hibride të Kontrollit - 2 orë (O), Kontrolla Optimale dhe Optimalizmi - 2 orë (O), Modelimi dhe simulimi elektronikë - 2 orë (Z).

2. Një (1) mësimdhënës për lëndët: Bazat e Inteligjences Artificiale - 3 orë (O), Mësimi me Përmirësim të Rinovueshëm - 2 ore (Z), Mekatronika - 2 orë (Z), Senzorë dhe Elektronika -3 orë (O), Automatizimi Industrial dhe Intelegjenca Artificiale - 3 orë (O).

1. **Kushtet e përgjithshme**

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, dhe Rregulloren Nr.01/1328 dt.26.06.2024 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

2. **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitat në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

a) Kërkesën për aplikim
b) Biografinë (CV);
c) Certifikatën / ekstraktin e lindjes;
d) Certifikatën e shtetësisë
e) Diplomat origjinale ose kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) të vërtetuara nga noteri (me vulë origjinale të noterit).
f) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë).
g) Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
h) Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
i) Dëshmi të lëshuar nga Gjykata, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është dënuar apo nën hetime;
j) Informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë;

3. **Mënyra e aplikimit**

1. Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit dhe së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzojnë në formë fizike dhe në formë elektronike.
2. Dokumentacioni në formë fizike duhet të dorëzohet në zyrën e arkivës AZ/04 në UKZ, kurse versioni elektronik (pasi të protokolohet kërkesa) të dërgohet në **info@uni-gjilan.net**.
3. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk është e nevojshme të skanohen në tërësi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për librat dhe monografi të botuar, duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
4. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara në adresen e lartëcekur nuk do të merren në shqyrtim.
5. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit, përkatësisht nga data **26.11.2026** deri më **11.12.2026** në orën **16.00.**
6. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

   http://www.uni-gjilan.net

UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY • GJILAN • 2013